



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 11 paragrafi 3 dhe 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për tërheqje të Aplikacionit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era për projektin “Wind Park-Zatriç”, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, KK Rahovec, të datës 02.11.2012 të ndërmarrjes “NEK UMWELTTECHNIK AG” Dega në Kosovë, me adresë rruga “Nënë Tereza” H. IV, Kati II Prishtinë, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 30 nëntor 2012 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** Kërkesa për tërheqje të Aplikacionit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era për projektin “Wind Park-Zatriç”, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, KK Rahovec, të ndërmarrjes “NEK UMWELTTECHNIK AG” Dega në Kosovë.
- II. REFUZHET** dhënia e autorizimit preliminar për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga era për projektin “Wind Park-Zatriç”, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, KK Rahovec të ndërmarrjes “NEK UMWELTTECHNIK AG” Dega në Kosovë.

## **A r s y e t i m**

- ZRRE me datë 26.06.2012 nga ndërmarrja “NEK UMWELTTECHNIK AG” Dega në Kosovë, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga era “Wind Park-Zatriç”, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, Komuna Rahovec.
- ZRRE me datë 26.07.2012 ka njoftuar aplikuesin se aplikacioni nuk është i kompletuar dhe për të proceduar më tutje duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara me Rregullën për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 02 nëntor 2012 nga përfaqësuesi i ndërmarrjes NEK UMWELTTECHNIK AG” Dega në Kosovë. ka pranuar kërkesën për tërheqje të aplikacionit të protokolluar me nr. 437/12 të datës 26 qershor 2012, dhe njëkohësisht ka njoftuar se për projektin në fjalë do të dorëzohet aplikacion i ri në emër të ndërmarrjes “Upwind Kosova I Ltd.”, e cila do të jetë ndërmarrje e regjistruar për ndërtim dhe operim të këtij projekti.



- ZRRE pas analizimit të kërkesës për tërheqje të aplikacionit dhe vlerësimit të kërkesës, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**III.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar